

Titulli i origjinalit:

Katharina Hacker

Die Habenichtse

Roman

Përktheu nga gjermanishtja: Elda Gjana-Boriçi

Redaktoi: Luan Xhafa

Korrektori: Ramazan Hushi

Përpunimi grafik: Mirela Mara

Suhrkamp

© Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main 2006

© e botimit në shqip: Shtëpia Botuese **“Besa”**

Tiranë, 2012

**Botues: Luan Xhafa**

1.

- Gjithçka do të ndryshojë,- tha Dave, kur makina që kishte sjellë rrobat u largua duke rrapëllirë. Pastaj ai eci deri te kisha, përpara së cilës qëndronte një famullitar, dhe e përshëndeti duke tundur dorën.

- Pemët kanë filluar të ndërrojnë ngjyrë, e sheh? - tha Dave, pasi jemi në shtator,- dhe qëndroi poshtë një rrap, që Sara të këpuste një gjethe.

- Sa e madhe është! - tha vajza me habi. Dave e këputi dhe e mbajti përpara fytyrës së saj.

- Më e madhe se fytyra jote, - tha ai me seriozitet.

- Përse jemi këtu? - e pyeti ajo dhe Dave ia shpjegoi me durim.

- Tani jemi në shtëpi.

- Dje jo? - pyeti ajo e pasigurt.

- Jo, - u përgjigj Dave, - dje jo, pasi sapo erdhëm.

- Dhe, po të jetonte teto Marta, ne do të banonim ende në Clapham,- i dha të drejtë Dave.

- Hip, - i tha ai, dhe u ul në gjunjë. Ajo e ngriti këmbën mbi kokën e tij dhe i preku flokët.

- Jo te flokët! - thirri Dave, dhe filloi të ecte. - A mund ta mbash mend? - e pyeti Dave, - Lady Margaret Road, numër 47.

Dhe Sara e përsëriti.

- Duhet ta mbash mend, po që se humbet ndonjë ditë,- tentoi ta përforcojë ai.

- Tani, - i tha solemnisht, - meqenëse do të shkosh në kopsht.

- Meqenëse do të shkoj në kopsht, - përsëriti Sara dhe iku me vrap drejt shtëpisë së saj të re.

Shtëpitë e stilit Viktorian radhiteshin njëra pas tjetrës dhe dalloheshin nga detajet e fasadave. Disa prej tyre kishin nga një apartament në katin përdhes, “garden flat”, të tjerat jo. Aty ku nuk kishte garden flat, kishte kopsht, një rrip i hollë toke, i rrethuar me një mur tullash që i përkiste apartamentit përdhes. Kjo hyrje e vogël të çonte nga rruga në një qilar, ku dikur ruhej qymyr dhe tani kishte mobilie të vjetra, dyshekë e televizorë të prishur. Aty kishte edhe një krevat fëmijësh.

- Sot ti duhet të jesh i gëzuar,- i tha atij e ëma. Pastaj ata u grindën për mbulesën që ishte mbi divan, një mbulesë që kishte si dizeno një bimë kacavjerrëse, me një tigër të madh në mes. Divani ndodhej në qoshk dhe tigri spikaste midis gjelbërimit.

Kur i ranë ziles, derën ua hapi mami, që u hodhi një vështrim të ngrirë.

- Ja dhe Poli! - thirri Sara, që qëndronte ende mbi shpatullat e Daves. Macja e zezë kërceu mbi mbështetësen e divanit, u shtriq dhe, putrat e saj prekën kokën e tigrin.- Do ta shohësh, - tha Dave në mbrëmje, i ulur buzë shtratit të saj, teksa i përkëdhelte flokët - këtu nuk është si në Clapham.

- Pasi shtëpitë janë ndryshe? - pyeti Sara.

- Pasi shtëpitë janë ndryshe, por dhe njerëzit,- tha ai,- babi do të gjejë një punë, e shikove si buzëqeshte mami?

Sara heshti. – Do të shkosh në shkollë, - tha Dave.

Pastaj ai u ngrit dhe u shtri në krevatin e tij.

- Dave?- thirri Sara, por atë e kishte zënë gjumi.

Dita tjetër ishte e hënë, ajo u zgjua nga zërat në korridor dhe nga përplasia e një dëre. Askush nuk hyri për ta zgjuar, pastaj dera u mbyll dhe ra heshtja. Ajo u ngrit, vrapoi te dritarja dhe pa një autobus të vogël. Shoferi shpalosi një shkallëz

dhe priti derisa nga shtëpia përballë të dilte një zonjë plakë dhe të hipte në autobus. Pastaj shoferi, që pinte cigare, kur hipo zonja palosi shkallët, u ul në vendin e vet dhe autobusi u nis. Dave kishte ikur, dhe prindët e saj gjithashtu. Poli u ngjesh te këmbët e Sarës. Në dhomën e ndenjes kishte ende arka dhe lodrat e saj ishin në njëren prej tyre. Pasdite Dave erdhi, i veshur me një uniformë të re shkollore. Ai e ndjeu menjëherë kutërbimin dhe e kuptoi se ajo e kishte bërë në brekë. Ai pa një njollë e vogël dhe bëri sikur po e godiste me grushte.

- Çfarë fitoj unë po të mos tregoj?

Pastaj ai e ndihmoi që të lante rrobat, por dukej i trishtuar.

- Do t' i varim te dritarja, - tha ai,- mami nuk do ta vërë re.

Dave kërkoi kukullën e saj, që ishte në një arkë në dhomën e ndenjes dhe, ndërkohë që ai po sistemonte rrobat, ajo u fsheh pas divanit dhe përkëdhelte Polin.

- Eja më ndihmo,- i tha Dave më vonë, ndërsa vendoste në vendet e tyre pjatat dhe orenditë e tjera. – Do ta shohësh, -tha ai, - mami do të sjellë për të ngrënë dhe në mbrëmje të katër do të ulemi rreth tavolinës.

- Edhe Poli? - pyeti Sara.

- Edhe Poli,- tha Dave.

2.

Televizori ishte vendosur mbi një tavolinë të ulët ngjyrë kafe, mbi parket dukeshin hijet e kullave që shembeshin, njerëzit që shpëpiteshin nga fasadat e kullave binjake e hidheshin drejt vdekjes. Mbi tavolinën e ngrënies kishte gota dhe pjata për tridhjetë të ftuar, por pjesa më e madhe e tyre nuk kishte ardhur.

Pasdite Ginka kishte blerë tre shishe xhin dhe një arkë me shveps, - për ata që pinin diçka më të fortë se vera, - tha ajo dhe u drejtua nga Jakobi, i cili ishte ftuar për herë të parë. Në mëngjes ai ishte kthyer nga Nju – Jorku dhe një ditë më parë kishte qenë në World Trade Center. Të gjithë u grumbulluan rreth tij si rreth një të mbijetuarit dhe i bënë pyetje të cilave ai nuk u përgjigjej pasi ishte i tronditur. Izabela u fut në dhomën e punës së Ginkas për t' i telefonuar Aleksës. Sekretaria telefonike u aktivizua dhe Izabela pyeti se ku po e kalonin mbrëmjen Aleksa e Klara. Përpara televizorit Izabela, me telefonin në dorë, shpërtheu në lot kur dëgjoi mesazhin e shkurtër të Aleksës. Asaj i duk absurde të qante për njerëz që i njihin dhe të linte pa vajtuar të vdekurit e tjerë të panumërt. Në zyrën e Ginkas ndodhej një divan i vogël, ngjyrë gri, veshja prej lëkure e të cilit ishte vjetruar nga përdorimi. Një jastëk kishte rrëshqitur dhe dikush ishte përpjekur të hiqte një njollë, pasi një çngjyrosje e lehtë e tregonte këtë. Ajo u ul, zgjidhi lidhëset pas një ngurrimi të vogël, shtriu këmbët në mbështetëse dhe deshi të mbyllte sytë, por trokiti dera dhe hyri Jakobi. Ai u ul i qetë pranë saj dhe këmbët e gruas thujse preknin qafën e tij.

- A të kujtohet, - e pyeti ai.

Ajo soditi pa kureshtje flokët e kuqërremtë të tij, tiparet e ëmbla të fytyrës, faqet e rrumbullakëta, të cilat bënë që goja të dukej më e vogël dhe të gjitha këto kompensoheshin nga hunda e madhe dhe balli i lartë. Në përgjithësi ai ishte i këndshëm. Asaj i kujtohej. Mbi një tavolinë të vjetër, të vogël e me këmbë të holla kishte një gotë me ujë dhe brenda saj ishin tre trëndafila të fishkur. Kërcejtë kishin ngjyrë të errët dhe brenda ujit vezullues notonte një gjethe, që dukej e madhe. Ginka thirri emrin e burrit që ia kapi dorën me kujdes,

ia mbajti në të tijën dhe priste. Frajburg, mendoi Izabela. Me gjithë vitet e lëna pas dhe grindjet e panumërta kujtesa vulli regjistrimet e saj. Trungjet e pemëve të lagura nga shiu, të zhveshur, që dukeshin të errët në perëndim, shkurret e rralluara, si të shpupuritura, stuhia, e cila nuk mundi të depëronte, në të përpjetën e thepisur të malit Brom, ku në verë poshtë aheve rritej bari si në një lëndinë, pasi pemët ishin larg njëra – tjetrës dhe asnjëra nuk shqetësohej nga prania e shoqes. Dhe, e habitur, ajo shqiptoi emrin e tij. Asaj iu kujtua shëtitja që kishin bërë përpara dhjetë vjetësh, pylli, perëndimi dhe lagështira, turbullimi që kishte ndjerë kur kishte prekur dorën e Jakobit, megjithëse e dinte se do të kthehej te i dashuri i saj, te bashkëjetesa e tyre e braktisur dhe poshtëruese. Dhe, përmes derës së mbyllur përgjysmë, një shirit drite ra mbi trëndafilat.

Jakobi merrte frymë i qetë, fytyra e saj ende nuk kishte rrudha, nishani në fytyrë ishte bërë më i madh, qafa dukej më e butë dhe ai kishte dëshirë ta puthte. Dhe sytë e saj iu përgjigjën me ëmbëlsi shikimit të tij. Atëherë në pyll ajo kishte pasur frikë, por kishte pranuar të shkonte në dhomën e tij prej studenti të ngrohur keq. Dhe ai e kuptoi se ajo nuk e kishte pritur.

Më pas, në derë u duk Ginka. Këpucët e saj kishin taka të larta dhe ajo hyri duke u ngërdheshur. Kur i pa të ulur në divan, shpërtheu në të qeshura dhe tha me zë të lartë disa fjalë që nuk i kuptoi askush.

Në shtëpi Izabela u përpoq edhe një herë të lidhej në telefon me Aleksën. Televizori ishte i ndezur dhe në ekran dukej aeroplani që fluturonte drejt kullës së dytë në vijë të drejtë.

Mëngjesin tjetër ajo erdhi në zyrë e para. Aktivizoi kompjuterin dhe hapi dritaret. Kalldrëmi i larë nga shiu i djeshëm dukej i freskët, ndërsa harqet me tulla të trasesë së tramvajit dukeshin të zbehta dhe sikur ndiheshin të pikëlluara për fundin e tyre. Mbi skrivaninë e Izabelës ishin projektet që i kishte kompjuterizuar për t'ia treguar Andrasit dhe Peterit, por që nuk kishte arritur ta bënte dhe emrat e pronarëve të firmës, Panier & Tarnov, shkëlqenin fort poshtë treguesit të aktivitetit të firmës: Mirëmbajtje shtëpish – (Administrata berlineze e shtëpive). Ajo realizonte me dëshirë detyrat e vogla që i besonin të dy burrat: etiketat e firmës, broshurën, letrën e shkrimit, kartëvizitat, që si bagëti të imta mund të linin edhe bajga.

Në orën dymbëdhjetë, kur erdhi Peteri, ajo shkoi të bënte pushimin e drekës, por, së pari, vrapoi te tregu i Hakeshit, që në atë kohë ishte më i qetë se zakonisht. Megjithëse kafenetë dhe restorantet ishin hapur, turistët rrinin ulur, të pavendosur për të vazhduar programin Sightseeing. Kudo kishte gazeta me fotografi. Izabela, e veshur me një fund të shkurtër, të ngushtë dhe me këpucë sportive, eci në rrugën Oranienburg. Përpara sinagogës kishte më shumë policë se zakonisht, pastaj u kthye dhe eci në rrugën Rozental. Qielli ishte i mbuluar, rrugët dhe vitrinat kishin një ngjyrë të zbardheme të turbullt, kalimtarët dukeshin sikur lëviznin pas një mbulese të hollë dhe sikur prisnin të fshiheshin brenda saj. Çfarë duhet të mendonte njeriu dhe me çfarë fytyre të paraqitej në qytet? Izabela ndali përpara një dyqani këpucësh që të këqyrte fytyrën e saj. Ajo hoqi kordonin nga flokët dhe ata u shpërndanë me lehtësi. Fytyra e saj e përsosur, kishte formë ovale të rregullt dhe dukej e zbehtë. Ajo e shtypi hundën nga e majta, pastaj nga e djathta. Pranë

saj, si e dalë nga toka, qëndronte një vajzë e vogël, që, pasi e imitoi dhe u ngërdhesh u largua me vrap, me këpucë të vogla prej balerine, ngjyrë ciklamini. Izabela u hodhi një sy këpucëve të veta dhe hyri në dyqan. Shitësja ngriti kokën, shtyu nga banaku gazetën e hapur, e la të binte përtokë, pa u merakosur për rrëzimin e atyre që në fotografi rrinin si të ngrirë në ajër. Në orën tetë, i kishte thënë Jakobi, do ta priste në Vyrgeengel, dhe problemi, mendoi Izabela, ishin këpucët. Asaj i mbetën sytë tek një palë këpucë me taka të ulëta, në formë gjysmëhëne, të gjata dhe të holla, me ngjyrë të zezë në kafe dhe pa shkëlqim. Në lartësinë e shpinës së këmbës, ato mbaheshin nga një llastik i zi. Izabela i provoi duke vrapuar përpara pasqyrës.

- Sot në darkë kam një date, tha ajo, dhe...

- Sot në mbrëmje? – deshi të sigurohej shitësja, sikur Izabela ta kishte njoftuar për një varrim. Ishte absurde të përfytyroje, si në një film të keq, që në vend të Jakobit, të shfaqej dashnori i saj nga Frajburgu, me rroba që mbanin erën e kashtës. Por, ashtu si Jakobi, edhe ai do ta kishte njohur menjëherë, pasi ajo nuk kishte ndryshuar që kur kishte qenë njëzet vjeçe. Fytyra e saj kishte mbetur e njëjtë, e lëmuar dhe e pafajshme.

Ajo eci përpara pasqyrës, duke parë këmbët e veta. Shitësja vështronte si kryqëzoheshin me njëra tjetrën këmbët e saj veshur me pantallona stofi, të gjata, të ngushta, dhe shihte me admirim këpucët e saj me taka të larta, ngjyrë trëndafil, që kishin një insekt ngjyrë ari në vend të tokëzës. Pastaj u ngërdhesh dhe heshti. Ajo mendoi se kishte harruar të vinte muzikë, por ç'muzikë vihej në një ditë të tillë, kur edhe makinat jashtë ecnin si të ishin pjesëmarrëse në një funeral! Përmes xhamit të vitrinave dukej një fëmijë me bi-

çikletë dhe e ëma që mbante zgarën e saj. Jakobi kishte thënë se ato do të shiheshin atë natë, në Vyrgenengel. Pra do të shiheshin sërish. Ai nuk duhej ta kishte thënë këtë dhe nuk kishte buzëqeshur, ndërsa Ginka zgërdhihej dhe mbyllte derën, duke e tërhequr me kujdes. Tak-tak zhurma e takave në formë gjysmëhëne mbi parket, muzika do të kishte ndihmuar tani, me ritmin e një kënge sentimentale. Shitësja u përkul me zhdërvjelltësi drejt një pajisjeje stereofonike, me ijet e saj të hijshme, me këmbët të përkulura, prapanica e saj e vogël u zgjat pas dhe bluza, që iu ngrit sipër, zbuloi një pjesë të kurrizit të bardhë.

Më në fund Izabela u lidh me Aleksën.

- Të lutem, çfarë mund të ketë ndodhur? Në sfond u dëgjua e qeshura e Klarës.

- Për çfarë shqetësohesh?

Izabela ndjeu një sëmbim në zemër, pasi e kishte kuptuar se nuk nuk ishte më violina e parë tek Aleksa, megjithëse kishin jetuar në një shtëpi dy vjet. Në vitin e parë berlinez Izabela kishte blerë rroba si e tërbuar, që të hiqte erën e qelbur të provincës, të Hajdelbergut, të Frajburgut, dhe ajo e kishte tallur. Aleksa kishte ikur te Klara, dhe që atëherë Izabela kishte mbledhur para, sikur po mblidhte të shkuarën dhe të ardhmen e saj. Nuk i prekte paratë që i dërgonin prindërit, për përdorim të lirë, siç i shkruante babai çdo Krishtlindje dhe çdo ditëlindje. Ndërkaq Izabela i zbathi këpucët, ndenji në parket me çorapet e zeza najlon dhe pyeti me kokë shitësen: 279 marka. Jashtë kaloi një tramvaj duke kuisur. Izabela futi atletet në qesen e letrës, mbathi këpucët e reja dhe dëgjoi zhurmën e takave në trotuar. Një djalë i vogël, që e vështroi me ca sy plot dritë, i hipi biçikletës dhe u zhduk duke u lëkundur dhe gati u rrëzua, kur u kthye

nga Izabela. Fëmijët e donin sikur ajo të ishte fëmijë. Je e veshur si një katërmbëdhjetë vjeçare e plakur, kishte thënë Aleksa kur kishte blerë të mbathura fëmijësh tip peshqir, me të cilat e fotografonte Izabelën. Dhe në ajër vinte rrotull një helikopter.

### 3.

Jakobi ishte ngritur herët dhe shkoi në zyrë në këmbë. Pas shiut të djeshëm rrugët ishin tharë, por ishte një ditë e freskët. Në mars ai kishte mbushur tridhjetetë vjeç dhe sukseset e vitit të shkuar i dukeshin pa rëndësi. Që nga ai çast koha do të rridhte më ngadalë; për atë që kishte kaluar, mjaftonin disa shënime për orientim, mendonte ai. Ajo ishte një tablo e thjeshtë, për të cilën mjaftonte një koment i shkurtër. Fytyrat serioze të kalimtarëve të parkët e nervozonin, pasi atyre nuk u kishte ndodhur asgjë, mendonte ai. Që nga vdekja e së ëmës, atë e kishin kursyer fatkeqësitë. Ajo kishte vdekur pak përpara ditëlindjes së tij të dymbëdhjetë dhe atëherë hallë Fini ishte vendosur tek ata dhe kishte gatuar me kënaqësi, pasi mendonte se vëllai i saj nuk ia dilte dot pa të prandaj martesë e tij me një mikroborgjeze nga Pomerania kishte dështuar. Pas vdekjes së nënës Jakobi nuk kishte folur disa javë me hallë Finin, pasi ajo kishte zbrazur studion e kunatës, Angritit. Letrat dhe fotografitë halla i hoqi, por hoqi edhe mobilie, dy kolltukë, një tavolinë të vogël, karriget me ngjyra të Jakobsenit, që Angrit Holbahu i kishte blerë në vitet shtatëdhjetë, stolat plastikë të tejdukshëm, edhe abazhurët. Por katër vjet më vonë, kur hallë Finit i ishte dashur të pastronte shtëpinë për hir të

mikeshës së re të vëllait të saj, Jakobi vuri re sa shumë kishte ndryshuar mjedisi. Ai u përpoq të kujtonte të ëmën, ngjyrat e çelëta dhe format e qarta që kishte preferuar ajo dhe e pushtoi malli, në çastin kur atij i duhej të zhvishej dhe të mos e hapte më derën në qetësinë e errët të shtëpisë. Edhe Gertruda nuk ishte e qetë. Ajo vinte mbrëmjeve në shtëpi, përpara babait të tij, me qese të mbushura, thërriste Jakobin në emër, vendoste në kuzhinë kasetat e saj të vjetra, Bitëllsat, Fats, Valler, Thelonious Monk. Por nuk zgjati shumë. Asgjë nuk zgjaste shumë në këtë shtëpi, në të cilën banorët jetonin si kalimtarë, që silleshin me kujdes me mobilet e huaja dhe prisnin të rinisnin udhëtimin. Babai i tij mbeti vetëm, pasi, ashtu si Jakobi, edhe Gertruda braktisi shtëpinë. Atij nuk i shkante mendja se ajo kishte qëndruar për shkak të tij, pasi ishte dashuruar me atë. Kur u largua, ajo mori me qira një autobus që do të çonte në Frajburg atë edhe teshat dhe e puthi në buzë. Dyshekun e vendosën bashkë në dhomën e tij të re dhe atij i erdhi keq që nuk kishte fjetur me të. Menjëherë pas kësaj, ai nisi një flirt me bashkëbanoren e tij me të cilën flinte, megjithatë e ruajti kujtimin e Gertrudës, e cila për atë e braktisi babain e tij. Prej saj priti një letër që nuk e mori kurrë, dhe tre vjet më vonë, kur ishte ulur pranë Izabelës në një leksion të historisë të së drejtës, u dashurua sërish.

Që kur ishim në kopsht, përgjigjej Jakobi, kur e pyesnin se kur e njihje Hansin. Por ata ishin njohur në Frajburg, ditën e mbërritjes së Jakobit. Atë ditë ai kishte blerë këpucë të reja dhe kishte shkuar në mensë për herë të parë, me këpucë të shtrenjta zotërinjsh, Bally-t, me të cilat donte të shënonte fillimin e kujtimeve të reja. Ata kishin ardhur në Frajburg, pa miq a bashkëshkollarë të studionin drejtësi

dhe rastisi që të ishin pranë njëri-tjetrit në radhën përpara mensës, në rrymën e ngrohtë të ajrit, përpara betonit të pistë dhe të gërvishtur, në aromën e gjellëve që Jakobit i ngjallnim krupën dhe Hansin e mrekullonin. Ata lëviznin, duke kaluar pranë një stende librash. Ky rit ekzekutohej çdo ditë dhe Jakobi e hidhte vështrimin te xhaketa prej lëkure e kafenjhtë e shokut, te tegelat që dukeshin të saktë dhe rezistentë. Meqenëse nuk ishte i kujdesshëm, ndodhte që ta shtynte padashur Hansin që rrinte përpara tij, me kartën e studentit në dorë, sikur të llogariste që çdo minutë do t'i duhet të përligjej. Ai ishte nga një fshat i vogël i Shvarcvaldit, ku prindërit e tij kishin një fermë..

Katër semestrat e parë ikën shpejt. Ata shkonin nëpër Bettlerpfad për në Shtaufen, më tej për Bazel. Udhëtonin me autostop deri në Strasburg. Dhe një herë, në Krishtlindje, Hansi e mori te prindërit e tij.

Ndërsa Hansi ndiqte leksionet e historisë së artit dhe nuk humbiste asnjë ekspozitë në Bazel a Shtutgart, Jakobit i pëlqente të shkante në kinema a në koncert, të interesohej për politikë, të studionte gazetatat, edhe të huajat. Një ditë pas rënies së Murit ai kishte vrapuar në mëngjes tek një agjenci udhëtimesh, kishte pritur sa të vinte pronari dhe kishte prenotuar dy fluturime për Berlin. Aeroplani nisej nga Shtutgarti, ai mori me qira një makinë dhe u nis me Hansin. Por ishin shumë vonë dhe nuk e arritën avionin. Pas kësaj kureshtja e Jakobit kishte rënë sërish, qeveritë e Modrovit dhe të Maiziere, komentet e babait të tij, i cili papritmas kishte filluar t'i telefononte thujse çdo ditë, i ngjallnin neveri. Ai ndjehej si një njeri të cilit po i rrëshqiste toka nën këmbë, pasi atdheu i tij, Republika Federale, nuk ekzistonte më. Hansi e tallte. Pastaj marrëveshja e bashkimit

dhe ligji për rregullimin e çështjeve të hapura të pasurive e detyruan Jakobin të punonte çdo ditë për t'iu përshtatur kushteve të reja. Një bisedë me të atin mbi këtë temë i dha fund telefonatave të tij. Për Krishtlindje hallë Fini sqaroi me ligësi, se ngjarje të tilla zgjonin kujtime të pakëndshme. Në vitet pesëdhjetë zoti Holbah kishte pasur frikë për firmën e tij, të cilën ia kishte blerë me një çmim të arsyeshëm partnerit hebre të gjyshit të Jakobit. Nuk dihej gjithmonë, sipas hallë Finit, se ç'të përgatiste e ardhmja. Jakobi i vuri vetes për detyrë që ta ndiqte këtë çështje, por termi arianizim e trembi. Më pas, në vjeshtë, ai njohu Izabelën. Në shëtitjen e parë që bënë bashkë ai e çoi në rrëpirën e Brombergut, ndërsa poshtë në luginë shihej Frajburgu me mjegull dhe vesë, dhe e përpiu Izabelën brenda një nate. Më 1992 Jakobi mori diplomën me temën: “Çështje të hapura pasurish.” Ai dhe Hansi vendosën të shpërnguleshin në Berlin. Më 1993 nisën stazhin në Berlin, Jakobi në zyrën Golbert & Shrajber, e cila ishte specializuar për kthimin dhe kompensimin e pasurive të paluajtshme në Berlin dhe Brandenburg. Por Izabelën ai nuk e hoqi kurrë nga mendja. Në jetën e tij private nuk kërkonte lidhje shkakësore. Mendimin se mund të interesohet për çështjet e kthimit të pronave për arsye se babait të tij do t'i duhej të përfshihej në çështje të tilla, ai nuk e pranonte. Në dashurinë ndaj Izabelës rol të madh kishte luajtur rastësia e takimit. Ai e kishte pritur gjatë dhe kjo e shqetësonte shumë.

Jakobi nuk ishte materialist, por ai i shmangej gjithçkaje që dukej misterioze, nuk i pëlqente asnjë motiv i fshehur dhe asnjë ndryshim që nuk ishte i dukshëm. Me tokat dhe me shtëpitë ai merrej me dëshirë. Udhëtonte me qejf nëpër Brandenburg. Ky vend e ndihmonte që të mësonte për një periudhë të errët, që ai nuk e njihte. Shkaqet e pakëndshme

nuk u ndërpre, por u pezulluan dhe këto i ndjeu gjatë udhëtimit përmes fshatrave, rrugës për një zyrë kadastrë, ku do të kontrollonte shpërngulje ose këmbime pasurie. Rrugë me kalldrëme që të çonin përmes fshatrash të humbur dhe të përgjumur, ku dritaret rrinin mbyllur që mos futej askush. Në fytyrat e klientëve shihej lakmi e frikë dhe përulje, të përzier me shpresë e urrejtje. Rrallë kishte bindje. Shpesh fytyrat dukeshin larg realitetit, sytë të mbuluar nga shtresat e historisë, që ai, fletë pas flete, regjistër pas regjistri, përpiquej t'i studionte në zyrat e kadastrës. Atij i dukej sikur ishte aktor i një loje “Mos u nxe, që vendoste në vendin e duhur aktet që kishin një pamje të rreme. Të denjë për mbrojtje dhe si rrjedhojë të ndershëm, duhet të ishin ata që ishin përshtatur me gjendjen ligjore që ekzistonte në RFGJ.

Ai e dinte përmendësh postulatën e Fibergut dhe Rajhenbahut në hyrjen e Ligjit mbi pronat. Kishte blerë qëllimisht një Golf të vjetër dhe jo një makinë të re. Por për shumicën ai ishte një i dërguar i fuqive fitimtare. Dhe Bashkimi Sovjetik nuk bënte më pjesë tek ato.

Pas stazhit, ai mori një ofertë nga Golbert & Shrajber. Vetë Shrajberi dhe Roberti, i cili kishte filluar punë bashkë me Jakobin, merreshin me paragrafin I, kryeradhën 6 të ligjit të pasurisë: “Ky ligj duhet zbatuar sipas kërkesave të së drejtës së pronës të qytetarëve dhe të shoqatave që u përdoqën për arsye raciste, politike, fetare apo pikëpamjesh nga 30 janari 1933 deri më 8 maj 1945 dhe humbën pasurinë e tyre si pasojë e shitjeve të detyruara, shpronësimeve a të ndonjë mënyre tjetër.” Dhe ai u specializua në çështjet e përparësisë së investimeve. Nëse pronari legjitim nuk gjendej, atëherë një investitor, pa dëmtuar kushtet e pasqaruara të pronës, mund të vinte në jetë planet e veta. Përpara vendimeve përfundimtare, jeta duhet të vazhdonte.

Hansi ishte strehuar në apartamentin e tyre të parë, në Rrugën e Vjenës. Edhe pasi Jakobi ishte shpërngulur prej kohësh, ata takoheshin atje çdo ditë. Ata ishin Jonasi, Mariana, Patriku, së bashku me të njohurit e tyre të përkohshëm, zakonisht piktorë, si Jonasi dhe Patriku apo gjermanistë, gazetarë, por edhe ndonjë avokat. Uleshin në tavolinën e gjatë dhe të lëkundshme, të cilën Patriku e kishte zgjatur dy metër e gjysmë me një pllakë tallashi të presuar dhe me dy këmbë. Një marrëveshje e heshtur kërkonte që çdokush duhej të sillte diçka për të ngrënë ose një shishe verë dhe më vonë, kur pas praktikës dhe provimit të dytë shtetëror filloi punën dhe fitonte mjaftueshëm, Hansi bleu tenxhere të mëdha, të reja, tiganë, një sobë tjetër dhe filloi të sillte edhe verë, duke mos pranuar që miqtë, të cilët jetonin me bursa dhe që e shtynin jetën nga shitja e rrallë e ndonjë tabloje, të sillnin një vizatim, një botim, ose një fotografi. Në një nga të dyja dhomat e mëdha, të cilat ai i kishte restauruar, kishte një dollap grafike. Muret ishin të zhveshur dhe të lyer me të bardhë.

Ndryshe nga Hansi, Jakobi u shpërngul me dëshirë. Librat dhe rrobat i futi në kuti kartoni dhe iku bashkë me to. Dhuroi shtratin, tavolinën dhe karrigen, bleu diçka të re, kështu edhe Hansi u rregullua më mirë.

- Idiot, çfarë kujton ti, përse e kam blerë unë këtë krevat? Sigurisht jo për të fjetur dhjetë vitet e ardhshme.

Kjo ishte njëra nga lojërat e tyre, të cilat funksionuan kaq gjatë dhe kaq mirë, aq sa Jakobi nganjëherë besonte se nuk ekzistonte mundësia që një ditë të bukur të zgjohej në mëngjes nga ndonjë e papritur e pakëndshme. Duke qenë se asnjëri prej tyre nuk kishte një mikeshë të qëndrueshme, ata ishin thujse një çift. Përse Hansi qëndronte vetëm, këtë ai nuk e dinte. Jakobi ndoshta nuk kishte takuar ndonjë

femër që ta frymëzonte, prandaj priste Izabelën. Ai kishte vendosur si afat dhjetë vjet, jo seriozisht, doemos. Po të mos e kishte rigjetur Izabelën deri në vitin 2001, atëherë do ta kishte harruar edhe këtë vendim.

Për të festuar suksesin, pasi në gusht të vitit 2001 ishte bërë ortak në firmën Golbert & Schraiber, Jakobi e ftoi Hansin te Dikmani, pas kësaj ata shkuan në Vyrngenel. Ishte rastësi që, ndërsa Hansi shkonte drejt banakut për të marrë dy uiski, Jakobi dëgjoi pa vëmendje zërat pranë tij. Ishte Izabela. Për herë të parë pas prej dhjetë vjetësh, ai dëgjoi emrin e saj. Nuk ishte e vështirë që të bisedoje me Ginkan. Kur ajo e ftoi për njëmbëdhjetë shtatorin, ai e zhvendosi në nëntë shtator takimin me investitorin njujorkez dhe luti Julian, sekretaren, që të ndryshonte prenotimin e fluturimit.

Mendoj për emrin e asaj që dikur e kishte admiruar, fytyrën e rregullt dhe të hutuar, që dukej sikur priste diçka, por pa qenë kureshtare. Ajo nuk i ngjante studenteve të juridikut dhe pretendonte se kishte dëshirë të studionte pikturë dhe dizajn. Atij i kujtohej fytyra e saj, gjinjtë e vegjël dhe hutimi karakteristik. Kam rigjetur Izabelën, i kishte thënë Hansit duke u zgërdhirë, në Vyrngenel.

Dhe vërtet e kishte gjetur. Ishte një ditë e turbullt, prandaj ai kishte frikë.

Ftesa ishte e vjetruar, festa nuk do të bëhej dhe ai shkoi me taksì në rrugën Shlyter, i kishte rënë ziles dhe e kishin lënë të hynte. Aty ishte Izabela.

Pas një paraditeje të lodhshme në zyrë, në pushimin e drekës ai shkoi i shqetësuar në drejtim të sheshit të Potsdamit dhe u kthye sërish në rrugën Mauer. Nuk donte t'i shihte gazetatat, nuk donte të dëgjonte copa bisedash. Ai një ditë më parë kishte qenë aty. Por ishte larguar në kohën e duhur. Kishte shpëtuar. Izabela, mendoi, ajo e kishte shpëtuar.



4.

Mae nuk ishte në vete, i varej atij në qafë, në kafazin e shkallëve dhe qante me dënësë. Ishte hysterike. Xhimi e kuptoi se televizori punonte. Ata kishin qenë rrugëve, Alberti, Beni edhe ai, dhe ishte grindur me Benin, ndërkohë Alberti kishte vënë sërish të njëjtat CD, që e shqetësonin Xhimin, njësoj sikur Alberti të urinonte në makinë. Nuk ishte muzika, por mënyra se si Alberti dëgjonte, duke lëvizur duart që i tundte në ajër plot kapadajllëk dhe kapte timonin vetëm kur ishte e pashmangshme dalja nga rruga, por edhe kur shfaqej ndonjë makinë policie, që atë ditë qarkullonin më shpesh se zakonisht në rrugën e tyre drejt jugut, rreth e rrotull dokeve dhe në rrugët e hyrjes në Silvertaun. Xhimi mallkoi, pasi këtë herë Beni kishte të drejtë të nervozohej. Ç'dreqin kërkonte policia këtu? Alberti nuk pranoi ta fikte radion dhe i ngriti zërin. Dëgjohej në kor, një zë artificial gruaje që tingëllonte në mënyrë elektronike, because it's been so long, that I can't explain and it's been so long, right noë, so wrong,<sup>1)</sup> Ai nuk arrinte ta hiqte këtë, zë kryeneç që të ngrinte nervat dhe menjëherë pas kësaj Alberti i kishte çuar në Pentonville Road. Dora e tij e kapë poshtë krahut dhe e tërhoqi te dhoma e ndenjës, në çastin kur në ekran shihej se po shembej kulla e dytë. Dhe bëri lidhjen midis figurave në ekran dhe hysterisë së Maes, midis makinave të policisë dhe të vdekurve. Por nuk e kuptoi se ç' po ndodhte. Mae fliste për të vdekurit dhe përkundej sikur po mbante në krah një fëmijë. Më vonë përsëriste ato që kishte dëgjuar dhe thoshte se asnjëherë asgjë nuk do të ishte si tani. Ajo

qau pandërprerë, sikur nga shembja e ngadaltë e kullave të kishte ndryshuar masa e kohës. Për ditë të tëra Mae nuk vuri dorë në kuzhinë dhe në dhomë. Më pas nga dritarja e hapur tapeti u lag dhe Mae tha se ai kutërbonte. Era e rëndë mbeti edhe pasi Xhimi hoqi tapetin. Kjo nuk ishte jetë. Po ç'i interesonte Maes, po atij ç'i interesonte? Në dyshtemenë e zhveshur shiheshin rripa të gjatë lënde ngjitesë. Ajo rrinte e mbledhur kruspull në divan, në divanin e verdhë, që ashtu si tavolinën e karriget, i kishte sjellë Alberti nga shtëpia e tij, për bashkëpunëtorët. Beni, i cili krenohet se ishte krahu i djathtë i Albertit kishte filluar t'i vardisej Maes. Një qelbanik dhe zvarranik i pështirë, që zemëroi Xhimin, pasi erdhi pa pyetur, që foli keq për shtëpinë që kutërbonte ku nuk kishte asgjë në frigorifer. Por kishte disa gjëra më të mëdha, në rrethinat e qytetit. Alberti mendonte se duhej të vidhnin shtëpitë e njerëzve që kishin ikur nga Londra. Por këtë paradite ndjeheshin më të sigurt, ndërsa mbretëronte qetësia dhe në lagjet e periferisë e në qyteza njerëzit nuk instalonin sisteme alarmi, edhe dritaret i linin hapur, pasi kishin besim te njëri – tjetri. Asnjë vjedhje nuk ishte bërë një vit më parë, por tani çdo gjë kishte ndryshuar dhe Xhimi përfytyroi qetësinë që mbretëronte në shtëpitë e vogla me kopshte përpara ose përreth. Ai nuk kishte dalë nga Londra prej dhjetë vjetësh, por tani të gjitha shtëpitë e periferisë ishin të mirëmbajtura, të paqta. Mae dhe ai nuk kishin krevat, por vetëm një dyshek. Rruga Fild Street nuk kishte asnjë pjesë të gjelbër, por vetëm zhurmë, kantiere ndërtimi dhe pisllek. Xhimi nuk e dinte se çfarë bënte Maeja kur dilte nga shtëpia. Në rrugën që të çonte në King's Cross, aty ku e kishte gjetur Alberti, kishte kaq zhurmë, saqë kolla e Maes mezi dëgjohej. Dhe ai mendonte për programet e rehabilitimit

për ata që kishin probleme. Por kush besonte te ato? Anti – droga, anti – prostitucioni, anti – krimi. Prandaj donte të largohej bashkë me Maen. Ajo shtrihej në divan dhe i premtonte se do të bënte kthesë. Ajo rrinte te dritarja kur ai ikte dhe ai e gjente të shtrirë në divan kur kthehej. Trupi i saj plogështohej kur ai e përqafohte. Pastaj ajo kollitej, aq sa atij i dukej sikur po shurdhohej. Dhe ai mendonte se do t'i duhej të mblidhte shumë para që të largoheshin. Asnjë vjedhje, vetëm drogë, kishte thënë Alberti. Pastaj sërish vjedhje, dhe Xhimi fitonte nga ato disa mijëra funte. Por kishte shumë policë që sorollateshin dhe kontrollonin. Vjeshta e vonë ishte e ftohtë dhe e lagësht. Dritaret nuk mbylleshin, ose Mae harronte t'i mbyllte. Ngrohja nuk funksiononte, ose funksiononte shumë mirë dhe bëhej shumë nxehtë, ndihej një erë e ngrohtë dhe Beni i kishte sjellë Maes tableta. Ajo qëndronte pranë dritares, rrinte drejt, kishte veshur një fustan leshi ngjyrë blu që i rrinte i ngushtë dhe nuk kishte mbathur këpucë. Dukej si një vajzë shkolle. Kofshët e saj të fuqishme dhe të këndshme ravijëzoheshin qartë. Mae e priste me buzëqeshje dhe pastaj shtrihej mbi një divan, që dikur kishte qenë i verdhë. Ajo përkulej para, villte, nga goja e saj rridhnin jargë dhe vazhdonte e dobësohej.

Ajo thoshte se i ishte neveritur pluhuri dhe se këtu nuk ishte më mirë se në Nju Jork. Pluhuri shkatërronte shumë njerëz, por asnjë nuk fliste për të vdekurit. Kishte ardhur dhjetori. Në vitin e ri, i tha Xhimi, do të largoheshin nga qyteti, do të nisnin një jetë të re dhe, kur të kishin para të mjaftueshme, do shpërnguleshin në fshat. Ajo donte të pinte çaj dhe ai i sillte Scones dhe KEK. Kantieri i ndërtimit rreth King's Cross vazhdonte të zgjerohej, madje u restaurua edhe Midland Grand. Alberti i tha se pas pak vitesh kjo do

të ishte një zonë e qetë dhe e pasur, ata do të ndiheshin të lumtur që jetonin në Field Street. Xhimi i kishte thënë se në qoftë se Mae nuk do të shkonte menjëherë te mjeku dhe nuk do të pushonte së piri tableta, nuk do të kishin nevojë për shtëpi të re.

Zakonisht uleshin përpara televizorit dhe Maen e zinte gjumi. Ai nuk e dinte, por ishte i sigurt se kundër tij ishte ngritur një kurth dhe këtë e tregonte fytyra e saj. Kur dilte, ai tërhoqte derën pas vetes, përgjonte, zbriste shkallët, por edhe kur dilte në rrugë, përgjonte. Një erë e acartë lëvizi letrat, ngriti përpara tij qese plastmasi, pluhur dhe paketa cigareje. Nga një hyrje, një djalë që e shikonte vjedhurazi, ia bëri me dorë. Janari iku. - Por lufta ka mbaruar prej kohësh, i tha ai asaj, - kullat, të vdekurit, gratë e mbuluara, ndërsa ajo rrinte shtrirë në divan, e mbledhur kruspull dhe qante. Beni vinte çdo ditë. Ajo e mohonte, por Xhimi ishte i sigurt. Por, kur Xhimi ulej pranë saj, në gjysmerrësirën e dritës së televizorit dhe i thoshte se ata do të kishin një kopsht, një avlli që ai do ta ngrinte me duart e tij, pasi babai i tij kishte qenë murator dhe në kopsht do të lulëzonin trëndafilat, ajo buzëqeshte. Ata do të pinin çaj, poshtë një qershie ose një arre. Ajo do të vinte me tabaka në dorë nga kuzhina në kopsht, nën qershinë e lulëzuar. Ishte ende ftohtë, por ata së shpejti do të dilnin shëtitje, mund të shkonin në Riçmond apo në Kev dhe të shëtisnin përgjatë Tamizit. Ai do ta çonte në kopshtin e Kevit, ku nuk kishin qenë kurrë, pasi atje duhet të ishte shumë bukur, këtë e thoshin të gjithë. Ajo ishte dobësuar shumë, pasi nuk hante dhe pinte shumë cigare, por edhe ai pinte. Beni sillte tabletat. Amfetaminë, valium dhe sapo Beni dilte nga shtëpia, Xhimi e kapte Maen nga shpatullat dhe e shkundte. Ai i kërkonte të mos e pranonte Benin në

shtëpi dhe i thoshte se pas ca javësh apo muajsh mund të largoheshin nga Londra në ndonjë fshat dhe do ta nisnin nga e para, madje ndoshta edhe mund të martoheshin. Kjo ishte jeta: të filloje nga e para. Kjo ishte jeta: të mos vdisje. Por Mae tha se ai ishte i mbushur me urrejtje prandaj e harroi ditëlindjen e saj.

Beni i kishte treguar asaj për Alisën. Nuk ishte tradhtia që e zemëronte Xhimin, por diçka më e thellë, që nuk mund ta shprehte, ashtu si nuk mund të thoshte se përse e shihte me dyshim Maen dhe mendonte se ai ishte shumë i largët për të. Më e keqja ishte se ajo nuk flinte me dëshirë me të. Madje kurrë nuk ishte kënaqur me atë. Alisa ishte tjetër, ajo i ishte dhënë, e kishte dashur, e kishte vënë në lojë, pastaj i kishte vjedhur treqind funt dhe ai ishte katandisur si mos më keq. Ishin të shumtë ata që dashuronin dhe urrenin, por nuk mund ta shpjegonin këtë. Alisa ishte një prostitutë me fytyrën e një kafshe dinake dhe kishte arritur ta mashtronte. Dhoma e saj në Arlington Road, me enët e pista, me gjilpërat dhe me radion që nuk e ndizte kurrë, i ishte neveritur. Si një kafshë, i tha Alberti i inatosur, pasi Beni pretendonte se ai nuk ishte sjellë mirë me atë.

- Kush je ti që ngrihesh mbi të tjerët? –thoshte Alberti. Mae ishte bërë njëzetepesë vjeç, por Xhimi e kishte harruar ditëlindjen e saj.

- Ti je i mbushur me urrejtje,- i tha Maeja.

Ai donte të shkonte me të në kinema.

- Gjithë vendi është mbushur me policë, ngado kontrole, - tha ajo dhe shtoi se nuk i pëlqente të shkonte me metro.

- E çfarë mund të na ndodhë me këtë pamje që kemi? Unë a dukem si arab? Apo ti? - e pyeti ai.

- Ai është plot urrejtje, - përsëriti Maeja. Beni erdhi,

qëndroi aty dhe i dëgjoi. Dy ditë më pas Xhimi nuk arriti të hapte një bravë dere dhe ata ishin larguar pa mbaruar punë. Alberti i kishte vënë dorën mbi shpatull dhe kishte qeshur me zë të lartë, derisa Xhimi ia kishte hequr dhe kishte vrapuar si i marrë. Alberti nuk ia kishte dhënë kurrë pjesën që i takonte. Ta ruaj unë, gjithçka i kam shënuar,- e qetësonte ai Xhimin dhe e tallte, - bëj durim. Ai u paguante shtëpinë, vrimën e vogël kutërbuese, banesën e tyre, dhe ata duhet t'i ishin mirënjohës për këtë. Ajo kishte qenë si shtëpi për ta, me dritaret që nuk mbylleshin mirë, me erën e keqe dhe Maeja, që mblidhej kutullaç në divan, thoshte se vazhdonte të shihte të vdekurit, të gjallët që hidheshin nga dritaret, se dëgjonte ende britmat e tyre, madje se dëgjonte edhe çfarë flisnin njerëzit që ishin mbyllur në ashensorë dhe në korridore. Por urrejtja, thoshte Maeja, dhe zemërimi i tyre do t'i godiste edhe ata, ata të dy.

- Si nuk e kemi ditur që ata na urrenin?

Ai heshtte. Makinat e policisë ulërinin në rrugë, nga e djathta në të majtë, pastaj ktheheshin sërish.

- Dhe të vdekurit, - thoshte Mae, - që i harruam, na thërrasin.

Xhimi hapte dritaren që të hynte ajër i freskët. Ishte shkurt dhe dëgjohej zhurma e makinerive të ndërtimit. Një herë ata shkuan të shëtisnin te kanali, vrapuan përgjatë tij dhe donin të vraponin deri te parku Voliere, por Maeja nuk kishte fuqi.

Më pas ai mendoi se ajo ishte zhdukur, por ajo ishte ulur në stol, e veshur me një pallto të vogël që nuk e mbërthente, megjithëse bënte ftohtë.

Ditën tjetër ai i tha Albertit se në të ardhmen donte pesëdhjetë për qind të fitimit në para të thata. Alberti qeshi, por doli ashtu siç i kishte thënë Xhimi: në qoftë se nuk ke frikë,